

VENDIM
Nr. 654, datë 10.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 605, DATË 14.9.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi parë, i pikës 11, të vendimit nr. 605, datë 14.9.2022, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlogariten në shumën 2 060 000 000 (dy miliardë e gjashtëdhjetë milionë) lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, miratuar në buxhetin e vitit 2022, të cilat ndahen: ...”.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku